

I dahshur Vincenzo po te dergoj dy poezi te shkurtra per konkursin.

Nese duhet vetem nje krijim, zgjidhe vete, krijimin qe te pelqen me shume nga poezite qe po te dergoj.

P.s. Ka mundesi te vij ne konkurs nese do te me sjellesh nje ftese dhe po mendoj te vij me disa miq qe mund te vijne, ose Rexhepi ose edhe ndonje njeri me kamera per ta pershkruar veprimtarine.

Do te te shkruaj perseri!

Me shkruaj kur t'i marresh poezite...!

Kur ka shkuar kaq kohë e gjatë

Kur ka shkuar kaq kohë e gjatë,
Rri dhe mendoj atë natë,
Atë natë kur të hodha një gur në dritare,
Kur më rrahu zemra guximtare,
Kur shpirti më hidhej pa pushim,
Kur hodha në tokë ngurrimin tim.

Kam ndjerë puthjen e buzëve të tua,
Ato më kënaqën gjer në shpirt mua.
Tani më ka kapur dëshira përsëri,
Porse s'kam ç't'i bëj vrullit në gji,
Duhet të vë këmbët në tokë
Dhe të mendoj për ndjenjën e ngrohtë...!

Në sytë, pra, që ke ti

Në sytë, pra, që ke ti,
Unë shikoj plot çudi.
Në rrugë këtu je
Edhe qesh me gaz e mall,
Aqsa natyrën qark e ngjall,
Se ç'shikim, ç'magji ke...?!

Ky shikim dhe kjo magji,
Të qëndron porsì stoli,

Ndaj zgjat dorën të prek,
Kur ecën pa një fjalë,
Dhe me zemër të pastër,
Të kam valë, më ke breg...!

Kur më jep një përqafim,
Në mëngjesin plot zbardhëllim,
Shkrihem porsì një vesë,
Mbi një lule të bukur,
Mbi një gjurmë të zhdukur
Hedh përsëri shpresë...!

[Faint, mirrored text from the reverse side of the page, including the poem's title and author's name.]

*Poesia e Shqipërisë
X. Cucucci*